

A dëshiron të mësosh për kulturën ushqimore suedeze dhe ndërkombëtare?
A dëshiron të kesh mundësi që të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit?
A dëshiron të punosh ose studijosh jashtë vendit?
A dëshiron të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri?
A dëshiron të keshë një kualifikim që të jep mundësi të mira për punësim?
Në atë rast, Programi i ushqimit mund të jetë për ty.

Te programi i ushqimit do të mësosh dituri të gjëra për përgatitje dhe trajtim të ushimeve. Por ti mund të zgjedhësh që të aftësosh shumë mirë në diçka që të intereson veçanërisht. Mendo vetëm se në çfarë mënyre ushqimi i formon ditët tona, sa rëndësi ka ushqimi kur kremtojmë diçka dhe sa lloje të ndryshme të ushqimeve ekzistojnë! Atëherë do të kuptosh me siguri se sa e madhe është lëmia e ushqimeve dhe se cilat mundësi i ke ti.

Te lëmia e ushqimeve ka një numër të madh të sipërmarrësve privat. Pikërisht për këtë arye të jepen ato baza që të nevojite, me qëllim që të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri.

Lëmia e ushqimeve është ndërkombëtare. Me dituri gjuhësore dhe me kuptim e interesim për kulturat e tjera, do të keshë mundësi të mira që të punosh ose studijosh jashtë vendit pas përfundimit të Programit të ushqimit.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e ushqimit mund të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga kurset që i ke zgjedhur. Në disa raste të jepet mundësia që fillimisht të punosh si çirak gjatë një viti apo gjatë disa viteve. Në atë rast do të marrësh rrogë çiraku dhe do të jepet mundësia të punosh së bashku me persona që janë të punësuar në lëminë tënde me qëllim që të mësosh prej tyre. Ato kanë dituri të posaçme dhe kanë përvojë pune të gjatë.

Nëse dëshiron, mund të zgjedhësh që të vazhdosh studimet pas gjimnazit. Mundesh të zgjedhësh një kualifikim të mëtejme te Fakulteti i profesioneve ose studime në universitet ose fakultet.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që i ke përfunduar studimet te Programi i ushqimit mundesh për shembull të kërkosh punë si bukëpjekës, pastičer, kasap, shitës mishi ose shitës në butiqe.

Përmbajtja e Programit

Programi i ushqimit përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë veçanta për Programin e ushqimit. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi nuk ka drejtimeve ndërkombëtare. Në vend të tyre, çdo shkollë ka mundësi që të krijojë drejtimet e veta. Shembull për drejtimet janë furrat e bukës, pastičeritë, prodhime të

freskëta, aktivitet kafaterishë, butiqe për ushqime dhe prodhime delikate, dyqane mishi, thertore ose industria e ushqimit.

Ti ndoshta ke ndonjë interesim të veçantë për të cilin mund të jetë e mundur të studijosh në një vend tjetër? Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve në rast se drejtimi është i përfshirë te programi shtetëror. Në atë rast do të keshë mundësi që të pranohesh tek drejtimi.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi i ushqimit do të kesh kontakte me tregun e punë që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijosh kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Ekzistojnë shumë punë të lëmia e ushqimeve. Kjo është mirë për ty që dëshiron të gjejsh një punë menjëherë pas gjimnazit. Por në rast se punësohesh, varret poashtu edhe nga llojet e kurseve që i ke ndjekur, sa përvojë praktike ke dhe në rast se do të mund të paramendosh të shpërngulesh ose të udhëtosh me qëllim që të punësoshesh. Shumica e punëve janë nëpër pastiçeri, por ka punë edhe në dyqane të mishit dhe në thertore.